



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", e konform nenit 15 dhe 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, e në mbështetje të nenit 4 paragrafi 1, lidhur me paragrafin 2, të Rregullores për ndarjen e bursave për nxënës/e dhe studentë/e të Komunës së Suharekës, 01-Nr-016-7790, të datës 30.01.2019, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, 28.01.2022, miratoi këtë:

V E N D I M
Për formimin e komisionit

Neni 1

Formohet komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve për ndarjen e bursave për studentë/e dhe nxënës/e të Komunës së Suharekës, në këtë përbërje:

- 1.1 Jehona RRAFSHI-----anëtare
- 1.2 Bajram BASHA -----anëtar
- 1.3 Elmaze BYTYÇI-----anëtare
- 1.4 Agim RRAQI-----anëtar
- 1.5 Sahadete KUQI-----anëtare

Neni 2

Detyrë e këtij komisioni është që të bënë shqyrtimin dhe selektimin e aplikacioneve që kanë konkurruar për bursa për student/e dhe nxënës/ dhe të ju ndanë bursa atyre që e meritojnë dhe i plotësojnë kushtet dhe kriteret konform dispozitave të Rregullores për ndarjen e bursave për nxënës/e dhe studentë/e të Komunës së Suharekës, me numër të protokollit 01-Nr-016-7790, të datës 30.01.2019 e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren me numër te protokollit 01-Nr-016-7543 të datës 29.01.2021.

Neni 3

3.1 Mandat i anëtareve të Komisionit zgjat aq sa zgjat mandati i rregullt i ligjor i anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Suharekë.

3.2 Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtareve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 4

4.1 Për punën që do ta kryej komision do të kompensohet nga 50€, për çdo mbledhje (seancë) që do ta mbajë, pagesa bëhet nga mjetet vetanake të Komunës së Suharekës.

4.2 Anëtarët e komisionit të lartcekur nuk mund të paguhen më shumë se 6, (gjashtë) mbledhje (seanca) të cilat mbahen brenda viti kalendarik.


Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS – SUHAREKË

01-Nr- 01616358

Me datë 28/01/2022



Kryesuesi i Kuvendit

Mr. ec Bexhet KUÇI